


# Vaksinimi



ALBANSK

**COVID-19 është ajo sëmundje, që mund ta zhvilloni, nëse infektoheni me koronavirus.**

**Mund të prekë të gjithë - gratë dhe burrat, të rinj dhe të mos-huar, pavarësisht kombësie dhe feje. Dhe mund të mos keni fat, dhe ju godet juve, edhe nëse bëni më të mirën tuaj për të respektuar të gjitha rregullat e distancës dhe higjienës.**

**Por tani kemi vakcina. Dhe kur vaksinohet, më pak njerëz do të infektohen dhe sëmuren ose të vdesin.**

Megjithëse vaksinat e koronavirusit janë zhvilluar në një kohë të shkurtër, shumë njerëz historikisht janë përfshirë në testimin e tyre. Dhe autoritetet shëndetësore vlerësojnë se vaksinat janë të dokumentuara mirë dhe janë shumë të sigurt. Prandaj, autoritetet shëndetësore bëjnë thirrje që të vaksinohen sa më shumë njerëz.

Vaksinimi është në baza vullnetare dhe falas. Të gjithë personave mbi moshën 16 vjeç do ju ofrohet vaksinimi.

Janë autoritetet shëndetësore që vendosin për renditjen. Fillimisht do të vaksinohen të gjithë personat mbi moshën 65 vjeç dhe persona tjerë me rrezik të rritur të sëmuren rëndë nga korona. Dhe më pas, të gjithë personat midis 16 dhe 64 vjet.

Ju do të njoftoheni në e-Boks kur të jetë radha juaj. Nëse jeni të liruar nga e-Boks, do të merrni një letër me postë. Disa personave mund tu ofrohen gjithashtu vakcina nga punëdhënësi, komuna e tyre e banimit ose mjeku i tyre.

Pasi të keni marrë ofertën e vaksinimit, mund të vizitoni web-faqen [www.vacciner.dk](http://www.vacciner.dk) dhe të rezervoni një takim në një nga qendrat e vaksinimit të rajonit. Nëse nuk ka kohë të lirë në momentin kur të shikoni, mund të kontrolloni përsëri më vonë gjatë ditës ose gjatë ditës tjetër.

Ju duhet të prisni të vaksinoheni nëse keni COVID-19, jeni shtatzënë, ushqeni me gji, keni temperaturë mbi 38 gradë ose keni një infeksion serioz siç është pneumonia. Nëse keni dyshime, këshillohuni me mjekun tuaj.

Edhe nëse jeni vaksinuar, duhet të vazhdoni të ndiqni këshillat e Autoriteteve daneze të Shëndetësis për distancë dhe higjienë. Ju mund të infektoni të tjerët edhe nëse jeni vaksinuar, për shembull duke prekur sipërfaqet e zakonshme.

Jini të kujdesëshëm, se ka shumë informacione të pasakta në internet në lidhje me koronavirusin, COVID-19 dhe vaksinat. Nëse doni një informacion të mirë dhe të sigurt, mund të shikoni në faqen e internetit të Autoriteteve daneze të Shëndetësis [www.sst.dk](http://www.sst.dk). Ju gjithashtu mund të telefononi në linjën e përbashkët të autoriteteve për korona në 7020 0233.

